



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. 2435 AKTI NR. 3521 VENDIMI

Date 02.06.2021

Date 23.12.2021

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere nga:

GJYQTARE: SHEFKIE DEMIRAJ (MATAJ)

Asistuar nga sekretare gjyqesore P. Gj., me pjesemarrjen e prokurorit Hysni Mulaj, sot me date 23.12.2021, shqyrtoi çeshtjen penale nr.2435 Akti ne ngarkim te:

Te PANDEHURit: J. Gj., i biri i . dhe ., i datëlindjes ., lindur dhe banues ne ., banese private ., ., me arsim . klase, me gjendje civile ., me gjendje gjyqesore i denuar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi «arrest në burg» ID . Mbrojtur ne gjykim nga av Ilir Haznedari nr license 1507 dhe nr nipti K61716506N , nr tel . dhe av. Ilir Murati identifikuar me nr license 1216 dhe nr nipti K 61912001V (zgjedhur me deklarate dhe me prokure te posacme nr . prot date 26.10.2021)

AKUZUAR: Per veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe municionit” dhe “Drejtimi i automjeteve ne menyre te parregullt ”

PARASHIKUAR: Nga nenet 278/1 dhe 291 te K.Penal

Gjykata administroi provat, degjoi palet qe perfundimisht kerkuan:

-Prokuror Hysni Mulaj : - Deklarimin fajtor te pandehurit J. Gj. per vepren penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe municionit” parashikuar nga neni 278/1 te K.Penal dhe ne baze te kesaj dispozite denimin e tij me 6 (gjashte)vite burgim.

-Deklarimin fajtor te pandehurit J. Gj. per vepren penale “Drejtimi i automjeteve ne menyre te parregullt ” parashikuar nga neni 291 (ne gjendje te dehur)te K.Penal dhe ne baze te kesaj dispozite denimin e tij me 3 (muaj)burgim.

-Ne aplikim te nenit 55 te K.Penal ,bashkimin e denimeve dhe caktimin e nje denimi perfundimtar per te pandehurin J. Gj. prej 6(gjashte) vite burgim .

-Ne aplikim te nenit 406/1 te K.Pr.Penale, zbritjen e nje te tretes se denimit dhe denimin perfundimisht te pandehurit J. Gj. , me 4(kater) vite burgim .

-Vuajtja e denimit ti filloje nga dita e arrestimit te tij qe perkon me daten 19.01.2021, ora 02.35 dhe llogaritja e denimit te behet sipas kritereve te neneit 57 te K.Penal .

-Vuajtja e denimit te behet ne nje nga burgjet e sigurise se zakonshme qe ka ne dispozicion DPB.

-Ne aplikim te nenit 37 te K.Penal , te pandehurit J. Gj. ti caktohet denimi plotesues "Ndalim per te drejtuar automjete " per nje afat prej 1 viti

-Prova materiale arme zjarri tip pistolete ". "e kalibrit . mm, me Nr... . fishekët te po ketij kalibri lene ne ruajajtje ne magazine e armatimit ne Komisariatin e policise nr 2 Tirane, sipas process-verbalit te dates ..2021, ti kaloje shtetit dhe administrimi i saj te behet konform ligjeve dhe rregullave ne fuqi.

-Shpenzimet e bera gjate hetimit paraprak te parapaguera nga shteti ne masen prej 500 lek ti ngarkohen te pandehurit J. Gj. .

Av. Ilir Murati kerkoi: Deklarimin fajtor te pandehurit J. Gj. per vepren penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe municionit parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal dhe denimin e tij me 5 (pese) vjet burgim.

-Deklarimin fajtor te pandehurit J. Gj.i per vepren penale "Drejtimi i automjeteve ne menyre te parregullt" parashikuar nga neni 291 i K.Penal dhe denimin e tij me 10 (dhjete) dite burgim.

-Ne baze te nenit 55 te K Penal ne bashkim te denimeve i pandehuri J. Gj. te denohet me 5 (pese) vjet burgim

-Ne aplikim te nenit 406/1 te K.Pr.Penale ti ulet 1/3 e denimit duke e denuar te pandehurin J. Gj. perfundimisht me 3(tre) vjet e 4(kater) muaj burgim

Aplikimin e nenit 59 te K Penal , me arsyetimet perkatese .

Gjykata, pasi e shqyrtoi çështjen ne teresi:

V E R E N

Se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar procedimin penal nr 421 te vitit 2021 në ngarkim të të pandehurit J. Gj. akuzuar për vepren penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe municionit" parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal dhe "Drejtimi i automjeteve ne menyre te parregullt , parashikuar nga neni 291 i K Penal.

Gjykata pasi studioi materialet e paraqitura per gjykim bazuar ne nenin 69 te K.Pr.Penale, çmoi se çështja eshte ne juridiksionin e saj dhe gjykimi duhet te behet perpara kesaj gjykate.

Kjo çështje ne baze te neneve 13 dhe 74 te K.Pr.Penale, eshte ne kompetencen lendore te kesaj gjykate, pasi vepra penale per te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet me trup gjykues te perbere nga nje gjyqtar.

Persa i perket kompetences tokesore, ajo percaktohet shprehimisht ne nenin 76 te K.Pr.Penale ku citohet se: "Kompetenca tokesore percaktohet, me rradhe, nga vendi ku eshte kryer ose tentohet te kryhet vepra penale, ose vendi ku ka ardhur pasoja". Persa me siper, perderisa vepra penale dyshohet se eshte kryer ne Tiranë, kompetente eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Gjithashtu, Gjykata ne veshtrim te neneve 13,15,16,17,18 te K.Pr.Penale, çmoi se nuk ekzistojne shkaqe papajtueshmerie, ose perjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pakundershtuar edhe nga palet, pas prezantimit te trupit gjykues.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor me procedure te gjykimit te shkurtuar ka rezultuar e provuar se: Me date ..2021, rreth ores ., gjate patrullimit punonjesit e policise te Seksionit te Patrulles se Pergjithshme "Shqiponja", ne rrugen ". " kane konstatuar automjetin tip . me

ngjyre te . me targa ., ne pronesi te ".", ku drejtues mjete ishte i pandehuri J. Gj.. Gjate kontrollit fizik te automjetit poshte sediles se drejtuesit te mjetit është gjetur nje send i dyshuar arme zjarri me mbishkrimin ". " ., me ngjyre te zeze me numer: .. dhe nje kreher me . (.) fisheke ku kreheri ishte brenda ne armen (.).

-Sipas aktit të ekspertimit tekniko-balisitk nr. . datë ..2021 ka rezultuar se: “Arma e zjarrit me nr. ., sekuestruar në automjetin me targë ., drejtuar nga shtetasi J. Gj. në Tiranë, më datë ..2021 është pistoletë luftarake e markës “.”, calibër . mm (.). Pistoleta është në gjendje të rregullt teknike dhe realizon qitje normale. Në tytën e pistoletës me nr. . nuk u evidentuan mbetje të faktorëve plotësues të qitjes. Gëzhojat e regjistruara në sistemin “.” nuk u identifikuan të qitura nga pistoletat “.” e kalibrit .mm, me Nr. .. . fishekët objekt ekspertimi janë fishekë standart luftarakë të fabrikuar të kalibrit . mm (.) që përdoren si municion për pistoletat dhe automatikët e kalibrit . mm. . fishekë objekt ekspertimi janë të rregullt teknisht dhe të përshtatshëm për qitje. Në kapsollën e tyre u evidentua nga një gjurmë goditje. Gjurma e goditjes nuk paraqet karakteristika të mjaftueshme me vlera identifikuese”.

-Sipas aktit të ekspertimit daktiloskopik-vlerësues nr. . datë ..2021 ka rezultuar se: “Në sipërfaqen e pistoletës, krehërit dhe fishekëve objekt ekspertimi, fiksuar me cilësinë e provës materiale në ngjarjen “Fiksim Prove”, në automjetin me targa ., me drejtues shtetasin J. Gj., ndodhur në datën ..2021 në Tiranë nuk u përfutuan gjurmë papilare të vlefshme për identifikim”.

Duke qene ne keto kushte eshte bere shoqerimi per ne ambjentet e Komisarariatit të Policise nr. 2 Tiranë per veprime te metejshme dhe ne ambjentet e Komisarariatit të Policise nr. 2, i eshte bere testi i alkoolit të pandehurit J. Gj. nga punonjesit e qarkullimit rrugor, me aparatit Dragger, ku nga testi i pare rezultoi 0, 53 mg/l dhe testi i dyte 0,54 mg/l.

I pandehuri J. Gj. ka deklaruar se, pistoletën që i kanë gjetur në automjet e kishte gjetur më parë dhe e kishte futur në makinë për ta dorëzuar në Komisariatin e Policisë. Në momentin që e ka gjetur dhe futur në makinë shoku i tij E. B. nuk ka qenë prezent dhe nuk ka pasur fare dijeni.

Personi nën hetim E. B. ka deklaruar se, nuk ka patur asnjë dijeni që shoku i tij J. Gj. kishte armë në makinë.

Ne rrethanat e lartpërmendura Organi i Prokurorise Rrethit Gjyqesor Tirane ka sjelle per gjykim procedimin penal nr. 421 te vitit 2021 në ngarkim të të pandehurit J. Gj. akuzuar për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe municionit” dhe “Drejtimi i automjeteve ne menyre te parregullt”, parashikuar nga nenet 278/1 dhe 291 te Kodit Penal.

Hetimi dhe gjykimi i çështjes ndaj te pandehurit J. Gj. eshte bere me mase sigurimit personal me karakter shtrengues « arrest ne burg » nga data e arrestimit ne flagrance 19.01.2021 e ne vijim .

Para se te filloje shqyrtimi gjyqesor i çështjes i pandehuri J. Gj. dhe mbrojtési i zgjedhur prej tij av. Ilir Haznedari i qendruan kerkeses qe te proçedohet me gjykim te posacem ate te shkurtuar ne gjendjen qe jane aktet e prokurorit duke shprehur pendim te thelle per kryerjen e vepres penale nga ana e tij, kerkesese te cilen e kane paraqitur ne séance paraprake. (neni 332/c i K Pr Penale)

Gjykata pasi mori mendimin pozitiv te prokurorit, e gjeti kerkesesen te te pandehurit dhe mbrojtésit te mbeshtetur ne ligj, neni 405/6 i K.Pr.Penale, proçedoi me gjykim te posacem

ate te shkurtuar, pasi çmoi se çeshtja mund te zgjidhej ne gjendjen qe jane aktet e prokurorit.Kunder ketij vendimi lejohet ankim bashke me vendimin perfundimtar.

Gjykata krijoi bindjen e bazuar ne prova se i pandehuri J. Gj. ka kryer vepren penale te parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal e per rrjedhoje duhet te pergjigjet penalisht.

Lidhur sa sipër Gjykata vëren se neni 278/1 i K.Penal parashikon se:

.....“Mbajtja e armeve, e armeve shperthyese , ose e lendeve plasese ne automjete apo ne cdo mjet tjeter te motorizuar, ne mjedise publike ose ne mjedise te hapura per publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetore perben veper penale dhe denohet me burgim nga nga pese deri ne shtate vjet ..

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se ligjvënësi ka parashikuar mbrojtje të posaçme juridike të marrëdhënieve te vendosura per te siguruar rendin dhe sigurine publike te mbrojtura posacerisht nga veprimet kriminale ose mosveprimet kriminale.

Veprimet që çënojnë marrëdhëniet e sipërpërmendura passjellin përgjegjësi penale. Këto veprime, për t’u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet qe :

Subjekti : I pandehuri J. Gj. ka mbushur moshen per pergjegjesi penale, eshte i pergjegjshem para ligjit dhe nuk ka shkaqe padenueshmerie.

Ana subjektive : I pandehuri J. Gj. vepren penale te parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal e ka kryer me dashje direkte.

Ana objektive :Vepra penale eshte kryer nga i pandehuri J. Gj. me veprime te kundraligjshme. Vepra penale eshte kryer me ane te mbajtjes se armes se zjarrit ne automjetin e tij pa leje te organeve kompetente shtetore.

Objekti :Jane cenuar nga pandehuri J. Gj. marredheniet juridike te vendosura me ligj per rendin e sigurine publike nga mbajtja armeve pa leje te organeve kompetente te mbrojtura posacerisht nga legjislacioni penal e per rrjedhoje duhet te pergjigjet penalisht.

Gjithashtu Gjykata krijoi bindjen e bazuar ne prova se i pandehuri J. Gj. ka kryer vepren penale te parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal e per rrjedhoje duhet te pergjigjet penalisht.

Lidhur sa sipër Gjykata vëren se neni 291 i K.Penal parashikon se:

“Drejtimi i automjeteve apo mjeteve te tjera te motorizuara ne gjendje te dehur, nen efektin e lendeve narkotike apo pa deshmime perkatese te aftesise denohet me burgim nga dhjete dite gjer ne tre vjet ”

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se ligjvënësi ka parashikuar mbrojtje të posaçme juridike të marrëdhënieve te vendosura ne Kodin Penal per te siguruar qarkullimin e rregullt te automjeteve qe lidhen me sigurine e jetes dhe te shendetit te njerezve te mbrojtura posacerisht nga legjislacioni penal.

Veprimet që çënojnë marrëdhëniet e sipërpërmendura passjellin përgjegjësi penale. Këto veprime, për t’u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet qe :

Subjekti: I pandehuri J. Gj. ka mbushur moshen per pergjegjesi penale, eshte i pergjegjshem para ligjit dhe nuk ka shkaqe padenueshmerie.

Ana subjektive : I pandehuri J. Gj. vepren penale e ka kryer me dashje.
Objekti: Jane cenuar nga i pandehuri J. Gj. marrëdhëniet juridike te vendosura ne Kodin Penal per te siguruar qarkullimin e rregullt te automjeteve qe lidhen me sigurine e jetes dhe te shendetit te njerezve te mbrojtura posacerisht nga legjislacioni penal.
Ana objektive: Vepra penale eshte kryer nga i pandehuri J. Gj. pasi ai ka drejtuar automjetin ne gjendje te dehur e per rrjedhoje duhet te pergjigjet penalisht.
Sa siper u provua me provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqesor si me poshte:
-Proces verbal kapje ne flagrance date ..2021.
-Raport sherbimi i policise date ..2021.
-Proces verbal per verifikimin me aparat Dragger ,date ..2021 +shiritin .
-Proces verbal per qyrrjen e mjetit date ..2021.(automjet me tagre .)
-Proces verbal sekuestrimi date 19.01.2021.
-Akt ekspertimi tekniko balistik nr .,date 02.02.2021 ku ka rezultuar se: “Arma e zjarrit me nr. ., sekuestruar në automjetin me targë ., drejtuar nga shtetasi J. Gj. në Tiranë, më datë 18.01.2021 është pistoletë luftarake e markës “.”, calibrë . mm (.). Pistoleta është në gjendje të rregullt teknike dhe realizon qitje normale. Në tytën e pistoletës me nr. . nuk u evidentuan mbetje të faktorëve plotësues të qitjes. Gëzhojat e regjistruara në sistemin “Arsenal” nuk u identifikuan të qitura nga pistoletat “.” e kalibrin . mm, me Nr. . . fishekët objekt ekspertimi janë fishekë standart luftarakë të fabrikuar të kalibrin . mm (.) që përdoren si municion për pistoletat dhe automatikët e kalibrin . mm. . fishekë objekt ekspertimi janë të rregullt teknikisht dhe të përshtatshëm për qitje. Në kapsollën e tyre u evidentua nga një gjurmë goditje. Gjurma e goditjes nuk paraqet karakteristika të mjaftueshme me vlera identifikuese”.
-Akt ekspertimi vlersues prove materiale nr .,date 03.02.2021 ka rezultuar se: “Në sipërfaqen e pistoletës, krehërit dhe fishekëve objekt ekspertimi, fiksuar me cilësinë e provës materiale në ngjarjen “Fiksim Prove”, në automjetin me targa ., me drejtues shtetasin J. Gj., ndodhur në datën 18.01.2021 në Tiranë nuk u përfutuan gjurmë papilare të vlefshme për identifikim”.
Deklarimet e personit nen hetim J. Gj. dhe E. B.
Si dhe te gjitha aktet e tjera proceduriale te ndodhura ne fashikullin e hetimit te procedimit penal nr. 421 të vitit 2021.
Gjykata procedoi me procedure te gjykimit te shkurtuar mbi kerkesen e te pandehurit dhe mbrojtësit te zgjedhur prej tij c'ka do te thote se gjykimi i çështjes u be me provat e sjella nga prokurori i çështjes, te cilat kishin vlere provuese per gjykatën ne lidhje me fajesine e te pandehurit Julian Gjoshi per veprat penale te parashikuara nga nenet 278/1 dhe 291 te K.Penal.
Gjykata bazuar ne nenin 152/1 te K.Pr.Penale ku parashtrohet se “...çdo prove i nenshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlere te paracaktuar. Gjykata i cmon provat sipas bindjes se formuar pas shqyrtimit te tyre ne teresi” pare ne kete kendveshtrim u shqyrtuan me vemendje provat e marra konform Ligjit Procedural Penal.
Këto prova të marra në tërësi e bindin plotësisht gjykatën për egzistencën e faktit dhe fajësinë e të pandehurit J. Gj., i cili duhet te deklarohet fajtor per veprat penale te parashikuar nga nenet 278/1 dhe 291 te K.Penal
Në caktimin e masës së dënimit gjykata merr ne konsiderate faktin se denimi ka karakter individual dhe ne kete kuptim, ne dhenien e tij duhet te mbahen parasysh rrezikshmeria e vepres penale, e autorit te saj, shkallen e fajesise, rrethanat lehtesuese dhe renduese me

qellim qe ai te jete ne pershtatshmeri dhe raport te drejte, jo vetem me rrezikshmerine e vepres dhe te autorit te saj, por dhe qe te jete i tille qe te vlejje per rehabilitimin e tij. Ne masen e denimit Gjykata ka parasysh rrezikshmerine shoqerore te vepres penale. Gjithashtu ka parasysh faktin se i pandehuri ka mbajtur qendrim pendues gjate hetimit dhe gjykimit ndaj vepres penale te kryer nga ana e tij. (neni 48/ç i K.Penal).

Nisur sa sipër Gjykata cmon se i pandehuri J. Gj. per vepren penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe municionit parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal duhet te denohet me 6 (gjashte) vjet burgim, per vepren penale “Drejtimi i automjeteve ne menyre te parregullt” parashikuar nga neni 291 i K.Penal duhet te denohet me 3 (tre) muaj burgim

Gjykata cmon se i pandehuri J. Gj. ne bashkim te denimeve (neni 55 i K Penal), duhet të dënohet me 6 (gjashte) vjet burgim.

Gjykata do te kete parasysh edhe zbatimin e nenit 406/1 te K.Pr Penale, pasi u procedua me gjykim te posacem ate te shkurtuar .

Gjykata cmon se per te pandehurin J. Gj. ndodhemi ne kushtet e nenit 59 te K.Penal , kerkese e bere nga mbrojtessi i te pandehurit.

Neni 59 i KPenal, sanksionon:

“Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës apo nevojave, vecanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale si dhe sjelljes pas kryerjes së veprës penale gjykata kur jep dënimin me burg deri në pesë vjet mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë duke pezulluar ekzekutimin e dënimit me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Gjykata merr ne konsiderate faktin se i pandehuri ka mbajtur qendrim pendues ndaj veprave penale te kryer nga ana e tij gjate shqyrtimit gjyqesor (neni 48/ç i K.Penal).

Gjykata ne aplikimin e nenit 59 te K Penal ka ne qender te vemendjes gjendjen e rende shendtesore te te pandehurit ku sipas raportiti te koronografise date 21.09.2020 eshte arritur ne konkluzion Infarkt akut miokardi pa ngritje te segmentiti ST, ne pacient me stenoze kritike te trunkut komun dhe semundje 3- vazale te artiereve koronare . Rekomandimet revaskularizim kirurgjikal urgjent (provuar ky fakt me raportit te koronografise date 21.09.2020 akte mjekesore te tjera te administruar ne fashikull si raporti i shtrimit date 10.07.2020, raporti i daljes date 24.07.2020, flete dalje date 24.07.2020)

Gjykata gjithashtu ne aplikimin e nenit 59 te K Penal ka ne qender te vemendjes faktin se i pandehuri dhe familja e tij gezojne respekt ne komunitetin ku jetojne (provuar ky fakt me karakteristike nr 203 prot date 22.06.2021)

I pandehuri jeton vetem me dy prinderit e tij te moshuar , (provuar ky fakt me certificate familjare date 22.06.2021)

Gjykata merr ne konsiderate edhe gjendjen e renduar shendetesore te babait te te pandehurit ku sipas aktit mjekesor nr 1213 regjistri leshuar nga mjekja J. C. ,nder te tjera thuhet se duhet te kete familjarin ne cdo moment per perkujdesje.

Gjykata ne qender te vemendjes ka faktin se nga eksperimet e kryera dhe krahasimet e gezhojave eshte konkluduar se “gezhojat e regjistruara ne sistemin arsenal” nuk u identifikuan te qitura nga psitoleta “.” e kalibrit . mm me nr ... Pra kjo arme nuk eshte perdorur ne asnje ngjarje te qitjes me arme .

Gjykata cmon se ky dënim është plotësisht i justifikueshëm ne raport me rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe municionit” dhe “Drejtimi i automjeteve ne menyre te parregullt” rrethanave të kryerjes së saj si dhe rrezikshmërinë e të pandehurit në rastin konkret duke aplikuar nenin 59 te K Penal. Gjithashtu Gjykata çmon se ky dënim do t'i shërbejë edukimit të të pandehurit, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga ai si dhe parandalimit të përgjithshëm të ketyre veprave penale në shoqëri.

Gjykata duhet te shprehet dhe per provat materiale te sekuestruar (neni 190 i K.Pr.Penale)

Duke qenë se i pandehuri J. Gj. u deklarua fajtor gjatë këtij gjykimi për veprën penale për të cilën u akuzua, bazuar në nenin 485 të K.Pr.Penale, i pandehuri detyrohet të paguajë shpenzimet e parapaguara nga shteti, si gjatë fazës së hetimeve paraprake ashtu dhe shpenzimet gjyqësore.

Gjykata pasi beri harmonizimin e te gjitha provave njera me tjetren krijoi bindjen e plote se i pandehuri Julian Gjoshi eshte autor i veprave penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe municionit” dhe “Drejtimi i automjeteve ne menyre te parregullt” parashikuar nga nenet 278/1 dhe 291 te K.Penal e per rrjedhoje duhet te pergjigjet sipas sanksioneve ligjore perkatese.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet 379/1, 382, 383, 384, 390 të K.Pr.Penale, 278/1, 291 47,59,61, 60/9, 60/10, 48/ç, 49, te K.Penal, 405/6 ,406/1, 190, 389,485, te K.Pr.Penale.

V E N D O S I

-Deklarimin fajtor te pandehurit J. Gj. per veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armeve, armeve shperthyese dhe municionit parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal dhe denimin e tij me 6 (gjashte) vjet burgim.

-Deklarimin fajtor te pandehurit J. Gj. per veprën penale “Drejtimi i automjeteve ne menyre te parregullt” parashikuar nga neni 291 i K.Penal dhe denimin e tij me 3(tre) muaj burgim.

-Ne baze te nenit 55 te K Penal ne bashkim te denimeve i pandehuri J. Gj. denohet me 6 (gjashte) vjet burgim

-Ne aplikim te nenit 406/1 te K.Pr.Penale i ulet 1/3 e denimit duke e denuar te pandehurin J. Gj. me 4(kater) vjet burgim.

-Vuajtja e denimit i fillon te pandehurit J. Gj. nga data e arrestimit ne flagrance 19.01.2021

- Ne aplikim te nenit 59 (te ndryshuar) te K.Penal urdherohet pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim te mbetur prej 2(dy) vjet , 7 (shtate) muaj e 9(nente) dite per te pandehurin J. Gj., duke e vene ne prove per nje afat kohor prej 3 (tre) vitesh, me kusht qe gjate kesaj kohe i pandehuri te mos kryeje veper tjeter penale.

Afati i proves i fillon te pandehurit nga e nesermja e shpalljes se vendimit te gjykates.

Urdherohet i pandehuri te mbaje kontakte te vazhdueshme me Zyren Vendore te Sherbimit te Proves Tirane duke e vene ate ne dijeni per ndryshimin e baneses (neni 61 i K Penal

- Urdherohet i pandehuri J. Gj. te mos shoqerohet me persona te caktuar kryesisht te denuar (neni 60/9 i K.Penal) .

-Urdherohet i pandehuri J. Gj. te mos zoteroje, mbaje apo perdore arme (neni 60/10 i K.Penal).

-Ne baze te nenit 37 te K .Penal te pandehurit J. Gj., i caktohet denimi plotesues "Ndalim per te drejtuar automjete " per nje afat prej 1 viti.

-Heqjen e masës së sigurimit personal me karakter shtrengues “Arrest në burg” caktuar ndaj te pandehurit kërkuesit J. Gj. me Vendimin Nr. 105/1 Akti, datë 10.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë .

Urdhërohet lirimi i menjehershëm i te pandehurit J. Gj., i biri i . dhe ., i datëlindjes . nga IEVP “Mine Peza” Tirane , me kusht qe ne ngarkim te tij te mos kete masa te tjera sigurimi personal “Arrest ne burg”, ose çdo denim tjeter penal me burgim.

-Bazuar ne nenin 190 te K Pr Penale provat materiale te sekuestruara me procesverbalin date 19.01.2021 :

1 (nje) arme zjarri ". " ., me ngjyre te zeze me numer numer: ..

-1 (nje) karikator me . (.) fisheke me kaliber . mm., te kalojne ne favor te shtetit.

-1 (një) telefon i markes . me ngjyre ., me kod tastjere nga ., ku brenda tij eshte numri ., ti kthehet te pandehurit J. Gj..

Shpenzimet proceduriale te parapaguara nga shteti gjate hetimeve paraprake dhe ato gjyqesore i ngarkohen te pandehurit J. Gj. .

Kundër këtij vendimi lejohet ankim nga palet në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesermja e njoftimit te ketij vendim .

U shpall sot ne Tirane, date 23.12.2021

SEKRETARE
P. Gj.

GJYQTARE
SHEFKIE DEMIRAJ (MATAJ)

Shpenzimet proceduriale te Prokurorise
500 (peseqind) lekë.

Shpenzimet gjyqesore ne séance paraprake
Njoftime 300 (treqind) Lekë

Shpenzimet gjyqesore te gjykimit ne themel
Njoftime 600 (gjashteqind) Lekë